



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA KOMERCIALE

---

K.DH.SH.II.nr. 1504/22

GJYKATA KOMERCIALE NE PRISHTINE-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar kolegji, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit D.... shpk nga fshati .... Komuna e Gjilanit të cilin e përfaqëson me autorizim H.J. avokat nga Gjilani kundër të paditurës G....shpk ne seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të parashtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, I.EK.nr.53/2019 të datës 14.12.2021, në seancën e Kolegjit të mbajtur me datë 25.10.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET ankesa e paditësit D.... shpk nga fshati .... Komuna e Gjilanit, ndërsa PRISHEN Aktvendimet e Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Ekonomike, I.EK.nr.53/2019 i datës 14.12.2021 dhe Aktvendimi I.EK.nr.53/2019 datës 09.06.2022, dhe çështja i kthehet Dhomës së Shkallës së Parë-Departamenti për çështje ekonomike i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në rigjykim dhe rivendosje.

A R S Y E T I M

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar e ka Konsideruar të tërhequr propozimin e paditësit,D.... shpk nga fshati .... Komuna e Gjilanit.

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditësit për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale të LPK-së, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të Gjykata e Apelit, ta aprovoj si të bazuar ankesën e paditësit, ashtu që të prishet Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, I.EK.nr.53/2019 i datës 09.06.2022, dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje, ose të aprovoj si të bazuar ankesën ashtu që të kthehet lënda në gjendjen e mëparshme. Përfaqësuesi i paditësit për shkaqe shëndetësore të cilat i ka pas qysh në mëngjes datës 13.12.2021 i njëjti e ka pasur të pamundur që të prezantoj në seancën e caktuar dhe i njëjti është detyruar që të bëj vizitë mjekësore po atë ditë dhe i njëjti është rekomanduar që të pushoj, meqenëse seanca veçëse kishte filluar dhe përfaqësuesi i paditësit H.J., në ato momente ishte në vizitë mjekësore, nuk kemi ushtruar kërkesë për shtyrje të seancës por kemi rezervuar të drejtën e

ushtrimit të kërkesës për kthim në gjendjen e mëparshme, dhe ankesës për kthim në gjendjen e mëparshme, provë: dokumentacioni mjekësor.

Përgjigje në ankesë nuk ka

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, dhe në kuptim të nenit 12 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, në drejtim të thënieve në ankesë, vlerësoi se;

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se gjykata e shkallës së parë me datë 13.12.2021 ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor, dhe në mungesë të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse, me propozimin e të autorizuarit të paditurit, gjykata ka marr Aktvendimin I.EK.nr.53/2019 dt.14.12.2021 me të cilin padinë e paditësit e ka konsideruar të tërhequr. Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit me datë 22.12.2021 i është drejtuar të njëjtës gjykatë, me Kërkesë për kthim në gjendjen e mëparshme duke arsyetuar mungesën në seancën gjyqësore dt.13.12.2021, se për shkak të problemeve shëndetësore nuk ka mund të prezantoj në seancën e caktuar, provë: dokumentacioni mjekësor i datës 13.12.2021.

Gjykata e shkallës së parë i ka dërguar paditësit vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore, dhe me Aktvendimin I.EK.nr.53/2019 dt.09.06.2022, e ka konsideruar të tërhequr propozimin e paditësit për kthimin në gjendjen e mëparshme për shkak të mos pagesës së taksës.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së, e vlerësoi aktvendimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë brenda kufijve të shkaqeve ankimore të theksuara në ankesë, duke i vështruar sipas detyrës zyrtare shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimin e drejtë të së drejtës materiale.

Gjykata e shkallës së dytë ka gjetur se aktvendimi është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 dhe 182 par. 2 pika (n), për arsye se aktvendimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktvendimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten dhe shkresat e lëndës, nuk janë treguar arsyet për faktet vendimtare respektivisht arsyet e dhëna janë të paqarta, ekzistojnë kundërthënie për faktet vendimtare midis asaj që jepet në arsyet e aktvendimeve dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës.

Kolegji vlerësoi se, gjykata e shkallës së parë, nuk ka marr vendim lidhur me kërkesën e paditësit për kthimin në gjendjen e mëparshme, të cilës kërkesë paditësi ka bashkangjitur edhe Raportin mjekësor datës 13.12.2021, por në këtë rast gjykata i ka dërguar përfaqësuesit të autorizuar të paditësit vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore.

Dispozita e nenit 133 të LPK-së parasheh:

133.1 Propozimin e paraqitur pas afatit, apo propozimin e palejueshëm për kthimin në gjendjen e mëparshme gjykata e hedhë poshtë me anë të aktvendimit.

133.2 Lidhur me propozimin për kthimin në gjendjen e mëparshme gjykata cakton seancë vetëm kur një gjë të tillë e propozon pala shprehimisht. Po që se faktet në të cilat mbështetet propozimi janë të ditura botërisht (notore) gjykata nuk cakton seancë në asnjë rast. Po në këtë mënyrë gjykata vepron edhe kur 27 faktet në të cilat mbështetet propozimi janë qartë të pajustificueshme, por edhe kur gjykata ka prova të mjaftueshme në dosjen e lëndës për dhënien e vendimit sipas propozimit për kthimin në gjendjen e mëparshme.

133.3 Kundër aktvendimit me të cilin aprovohet propozimi për kthimin në gjendje të mëparshme nuk lejohet ankim i veçantë.

133.4 Kundër aktvendimit me të cilin refuzohet propozimi për kthimin në gjendje të mëparshme nuk lejohet ankim i veçantë, përveç kur propozimi paraqitet nga shkaku i dhënies së aktgjykimit për shkak të mungesës së palës së paditur nga seanca gjyqësore.

Kolegji, vlerësoi se gjykata e shkallës së parë, nuk ka vepruar në vështrim të këtyre dispozitave ligjore si më lartë, për të vendosur lidhur me kërkesën e palës paditëse, për kthimin në gjendjen e mëparshme, por ndërmerr veprime krejtësisht jo të drejta, duke mos zbatuar drejt ligjin, ashtu që i dërgon palës paditëse vërejtjen për pagesë të taksës gjyqësore me datë 18.02.2022. Kolegji, nga kjo gjendje e krijuar gjatë procedimit të lëndës nga gjykata e shkallës së parë, nuk mund ta pranojë këtë qëndrim si të drejt dhe ligjor të gjykatës së shkallës së parë, nga shkaku se në këtë fazë të vendimmarrjes gjykata e shkallës së parë ka qenë e obliguar të nxjerr vendim në vështrim të nenit 133 të LPK-se, e jo tani të ndërmerr veprime krejtësisht tjera që nuk kanë të bëjnë me kërkesën e palës paditëse, ashtu që e njëjta gjykatë në të njëjtën çështje juridike, vazhdon të nxjerr tjetër Aktvendim I.EK.nr.53/2019 dt.09.06.2022 me të cilin e konsideron të tërhequr propozimin e paditësit për kthimin në gjendjen e mëparshme për shkak të mos pagesës së taksës.

Gjatë procedurës gjyqësore gjykata e shkallës së parë ka qenë e obliguar të veproj konform dispozitave ligjore në fuqi, dhe kërkesave të palëve ndërgjyqëse, për ti vërtetuar pretendimet dhe faktet që e mbështesin Kërkesën për kthimin e gjendjes së mëparshme, dhe në fund të vendoset në vështrim të dispozitës së nenit 133 të LPK-së. Kolegji nga shkresat e lëndës, vlerësoi, se një veprim i tillë nuk është ndërmarr nga gjykata e shkallës së parë, e cila rrethanë ka pasur ndikim në gjykimin e kësaj çështje juridike. Mos vërtetimi i pretendimeve për kthimin në gjendjen e mëparshme të cilës i është bashkangjitur Raporti mjekësor i datës 13.12.2021, si provë e cila ka ndikim të drejtpërdrejtë në nxjerrjen e vendimit nga gjykata e shkallës së parë, përbejnë shkelje të dispozitës së Nenit 183.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Ekziston vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike kur gjykata gabimisht e ka vërtetuar ndonjë fakt vendimtar, përkatësisht kur faktin e tillë nuk e ka vërtetuar fare”*.

Shkeljet e tilla përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 183.1 të LPK-së, që kanë pasur ndikim në marrjen e aktvendimit të ligjshëm dhe të drejtë dhe si rrjedhojë gabimisht është aplikuar edhe e drejta materiale, aplikimin e drejtë të secilës në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjykata e shkallës së dytë e vlerëson sipas detyrës zyrtare, andaj aktvendimet e nxjerra nga gjykata e shkallës së parë, të nxjerra në mënyrë të kundërligjshme, doemos është dashur të prishen.

Në ri-procedurë gjykata e shkallës së parë duhet evituar shkeljet e theksuara më lartë, në atë mënyrë që të eviton kundërthëniet ekzistuese në shkresat e lëndës, ashtu që detyrohet të vendos lidhur me Kërkesën e paditësit për kthimin në gjendjen e mëparshme datës 22.12.2021 e paraqitur në gjykatë, në vështrim të nenit 133 të LPK-së.

Nga të cekurat u vendos sikurse në vendim në bazë të nenit 195.1 nën pikën c) të LPK.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË  
Dhoma e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II.nr. 1504/22 date 25.10.2022

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,  
Krenar Berisha